

VENDIM
Nr. 457, datë 9.7.2014

PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR. 1114, DATË 30.7.2008, TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE, “PËR DISA ÇËSHTJE NË ZBATIM TË LIGJEVE NR. 7703, DATË 11.5.1993, “PËR
SIGURIMET SHOQËRORE NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË””, TË NDRYSHUAR, NR. 9136, DATË
11.9.2003, “PËR MBLEDHJEN E KONTRIBUTEVE TË DETYRUESHME TË SIGURIMEVE
SHOQËRORE DHE SHËNDETËSORE NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË”, TË NDRYSHUAR, DHE
NR. 10383, DATË 24.2.2011, “PËR SIGURIMIN E DETYRUESHËM TË KUJDESIT SHËNDETËSOR NË
REPUBLIKËN E SHQIPËRISË”, TË NDRYSHUAR”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të ligjit nr. 7703, datë 11.5.1993, “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe të ligjit nr. 10383, datë 24.2.2011, “Për sigurimin e detyrueshëm të kujdesit shëndetësor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Mirëqenies Sociale dhe Rinisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në vendimin nr. 1114, datë 30.7.2008, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, bëhen këto ndryshime:

1. Paragrafi i parë i pikës 2 të kreut II ndryshohet, si më poshtë vijon:

“Paga minimale mujore, për efekt të llogaritjes së kontributeve të sigurimeve shoqërore e shëndetësore, nga data 1.8.2014 e në vazhdim, të jetë jo më pak se 19 406 (nëntëmbëdhjetë mijë e katërqind e gjashtë) lekë. Paga maksimale mujore, për efekt të llogaritjes së kontributit të sigurimeve shoqërore, nga data 1.8.2014 e në vazhdim, të jetë 97 030 (nëntëdhjetë e shtatë mijë e tridhjetë) lekë. Paga maksimale mujore, për efekt të llogaritjes së kontributit të sigurimeve shëndetësore, nga data 1.8.2014 e në vazhdim, të jetë paga bruto, sipas përcaktimeve në pikën 1, të kreut II, “Paga bruto dhe paga minimale”.

2. Pikat 1, 2, 6, 7, 9, 10, 11, 12 e 13, të kreut III, ndryshohen, si më poshtë vijon:

“1. Shuma minimale mujore e kontributeve për të gjitha degët e sigurimit, për periudhën nga data 1.8.2014 e në vazhdim, të jetë 5 415 (pesë mijë e katërqind pesëmbëdhjetë) lekë.

Kontributi minimal mujor sipas degëve të sigurimit të jetë:

	në %	në lekë
Dega e sigurimit të sëmundjeve	0.3	58
Dega e sigurimit të barrëlindjeve	1.4	272
Dega e sigurimit të pensioneve	21.6	4192
Dega e sigurimit të aksidenteve dhe sëmundjeve profesionale	0.3	58
Dega e sigurimit të papunësisë	0.9	175
Sigurimet shëndetësore	3.4	660

2. Shuma minimale mujore e kontributit të sigurimit shëndetësor për të vetëpunësuarin dhe për pjesëtarët e familjes të patrajtuar me pagë, me përjashtim të të vetëpunësuarve në bujqësi, të jetë 3.4 për qind e dyfishit të pagës minimale mujore, e barabartë me 1 320 (një mijë e treqind e njëzet) lekë.

...

6. I vetëpunësuar, i vetëpunësuar në ortakëri, i vetëpunësuar, që punëson të tretë (me përjashtim të të vetëpunësuarit në bujqësi), duke filluar nga data 1.8.2014 e në vazhdim, të paguajë për vete një kontribut të detyrueshëm për sigurimet shoqërore, në masën 23 për qind të pagës mujore minimale prej 19 406 (nëntëmbëdhjetë mijë e katërqind e gjashtë) lekësh, e barabartë me 4 463 (katër mijë e katërqind e gjashtëdhjetë e tre) lekë në muaj. I vetëpunësuar, i vetëpunësuar në ortakëri, i vetëpunësuar, që punëson të tretë (me përjashtim të të vetëpunësuarit në bujqësi), duke filluar nga data 1.8.2014 e në vazhdim, të paguajë për vete një kontribut të detyrueshëm për sigurimet shëndetësore, në masën 3.4 për qind e dyfishit të pagës minimale mujore, e barabartë me 1 320 (një mijë e treqind e njëzet) lekë në muaj.

7. I vetëpunësuar, për pjesëtarët e familjes së tij mbi 16 vjeç, që nuk trajtohen me pagë, por që punojnë e bashkëjetojnë me të ligjërisht (me përjashtim të të vetëpunësuarit në bujqësi), duke filluar nga data 1.8.2014 e në vazhdim, të paguajë kontribut të detyrueshëm për sigurimet shoqërore, në masën 23 për qind të pagës mujore minimale prej 19 406 (nëntëmbëdhjetë mijë e katërqind e gjashtë) lekësh, e barabartë me 4 463 (katër mijë e

katërqind e gjashtëdhjetë e tre) lekë në muaj. I vetëpunësuar, për pjesëtarët e familjes së tij mbi 18 vjeç, që nuk trajtohen me pagë, por që punojnë e bashkëjetojnë me të ligjërisht (me përjashtim të të vetëpunësuarit në bujqësi), duke filluar nga data 1.8.2014 e në vazhdim, të paguajë një kontribut të detyrueshëm për sigurimet shëndetësore, në masën 3.4 për qind e dyfishit të pagës minimale mujore, e barabartë me 1 320 (një mijë e treqind e njëzet) lekë në muaj.

...

9. Personat e vetëpunësuar në veprimtari tregtare apo shërbimi, ambulante, nga data 1.8.2014 e në vazhdim, të deklarojnë dhe të paguajnë kontribut minimal mujor, në shumën 4 070 (katër mijë e shtatëdhjetë) lekë, nga të cilat 2 750 (dy mijë e shtatëqind e pesëdhjetë) lekë për sigurime shoqërore dhe 1 320 (një mijë e treqind e njëzet) lekë për sigurime shëndetësore.

10. Personat mbi 18 vjeç, me të ardhura të rregullta nga pronësia e që nuk janë të punësuar diku tjetër, duke filluar nga 1.8.2014 e në vazhdim, të paguajnë një kontribut të detyrueshëm për sigurimet shëndetësore, në masën 3.4 për qind e dyfishit të pagës minimale mujore, e barabartë me 1 320 (një mijë e treqind e njëzet) lekë në muaj.

11. Të vetëpunësuarit në bujqësi, nga data 1.8.2014 e në vazhdim, të derdhin kontribut vjetor për sigurimet shoqërore, në masën 33 000 (tridhjetë e tre mijë) lekë, me përjashtim të të vetëpunësuarve, që banojnë në rrethet Bulqizë, Dibër, Gramsh, Has, Kolonjë, Kukës, Librazhd, Malësi e Madhe, Mat, Mirditë, Pukë, Skrapar, Tepelenë dhe Tropojë, për të cilët masa e kontributit vjetor është 25 300 (njëzet e pesë mijë e treqind) lekë.

12. Paga minimale mujore për efekt të llogaritjes së sigurimeve shëndetësore për të vetëpunësuarit në bujqësi është 4 620 (katër mijë e gjashtëqind e njëzet) lekë. Të vetëpunësuarit në bujqësi, nga data 1.8.2014 e në vazhdim, të derdhin kontribut mujor për sigurimet shëndetësore, në masën 3.4 për qind e dyfishit të pagës minimale mujore, për efekt të kontributeve të sigurimeve shëndetësore të të vetëpunësuarve në bujqësi, të barabartë me një vlerë 314 (treqind e katërbëdhjetë) lekë në muaj.

13. Për personat, që punojnë si punëtorë shtëpie, nga data 1.8.2014 e në vazhdim, të deklarohet dhe të paguhet kontribut minimal mujor në shumën 4 070 (katër mijë e shtatëdhjetë) lekë, nga të cilat 2 750 (dy mijë e shtatëqind e pesëdhjetë) lekë për sigurime shoqërore dhe 1 320 (një mijë e treqind e njëzet) lekë për sigurime shëndetësore.”.

3. Kreu VIII ndryshohet, si më poshtë vijon:

“VIII. SHUMA BAZË E PËRFITIMEVE

1. Në mbështetje të neneve 2, 32, 36 e 48, të ligjit nr. 7703, datë 11.5.1993, “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, shuma bazë e përfitimit, nga data 1.8.2014 e në vazhdim, të jetë 12 264 (dymbëdhjetë mijë e dyqind e gjashtëdhjetë e katër) lekë në muaj.

2. Në mbështetje të nenit 96, të ligjit nr. 7703, datë 11.5.1993, “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, shuma e përfitimit për personat, që nuk plotësojnë kushtet për përfitimin e masës së pensionit, të përcaktuar në pikën 1, të këtij kreu, nga data 1.8.2014 e në vazhdim, të jetë 8 398 (tetë mijë e treqind e nëntëdhjetë e tetë) lekë në muaj.

3. Në mbështetje të pikës 4, të nenit 27, të ligjit nr. 7703, datë 11.5.1993, “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, shuma bazë e përfitimit për gratë, të cilat e kanë periudhën e fundit të sigurimit si të vetëpunësuar në bujqësi, nga data 1.8.2014 e në vazhdim, të jetë të jetë 8 398 (tetë mijë e treqind e nëntëdhjetë e tetë) lekë në muaj.”.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare dhe i shtrin efektet nga data 1.8.2014.

KRYEMINISTRI
Edi Rama